



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 507 Prot.

Maliq, më 24.09.2021

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, "Funksionimi i këshillit bashkiak", pika 2, pika 4, 5 neni 56 "Kryetari i këshillit bashkiak" pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq" ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq, do të zhvillohet elektronikisht dhe fizikisht në sallë e këshillit bashkiak, si pasojë e zbatimit të protokolleve të sigurisë mbi COVID-19, ditën e **mërkurë, më datë 29.09.2021, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.08.2021;
3. Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë këshillit bashkiak "Mbi heqjen e mandatit të znj. Evisa Jorgo Demollari", pas kërkesës për dorëheqje;
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2021";
5. P-V "Për miratimin në parim të përdorimit të fondit të deleguar nga fondi social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të projektit "Qendër emergjente për fëmijët";
6. P-V "Për miratimin e raportit të monitorimit 8-mujor, viti 2021";
7. P-V "Për miratimin në parim të fillimit të procedurave për vlersimin e godinës ekzistuese të kopshtit Maliq, si dhe shqyrtimin e mundësisë së rritjes të kapaciteteve të kopshtit ndërmjet mënyrave të fitimit të pronësisë";
8. P-V "Për miratimin e dokumentit të politikave dhe planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2022";
9. Diskutime të tjera.

Ju faleminderit!

NË MUNGESË

DHE ME PORSI

ZV/KRYETARI I KËSHILLIT

Gentiana DRABO

